

## RELACION

### Mbi Ecurine Financiare Buxhetore të AMSHC-se për 3- mujorin e fundit të vitit 2013

Agjencise per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile, në mbështetje të ligjit nr. Nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Per buxhetin e shtetit për vitin 2013”, Udhezimit nr. 1 datë 03.01.2013 “Per procedurat standarte te zbatimin te buxhetin”

dhe Udhezimit nr.2 datë 06.02.2013 “Per zbatimin e buxhetin e shtetit për vitin 2013”, i është akorduar një fond i planifikuar prej 117 milione e 900 mijë lekë, i cili përbehet nga:

Me ndryshimet e bera ne buxhet gjate vitit 2013 dhe te pasqyruara sakte edhe me poshte ne vijim te ketij Raporti, Fondi per AMSHC –ne ne Dhjetor 2013, ndahet sipas kategorive te listuara me poshte:

<b>Fondi i Pagave:</b>	<b>11,000,000 Lekë (zeri 600)</b>
<b>Fondi i Sigurimeve Shoqerore:</b>	<b>1,700,000 leke (zeri 601)</b>
<b>Fondi per Shpenzime Operative:</b>	<b>3,010,000 Lekë (zeri 602)</b>
<b>Fondi per transfertat ndaj te treteve:</b>	<b>99,700,000 Lekë (zeri 604)</b>
<b>Fondi per Investimet e Trupezuara:</b>	<b>1,500,000 Lekë (zeri 231)</b>
<b>TOTAL</b>	<b>116,910,000 LEKE</b>

Nga fondi i pergjithshem buxhetor, per periudhen e raportuar, AMSHC, ka realizuar vlerën buxhetore në **114,048,898 leke** nga totali prej **116,910,000 Leke** ose **97.5 %** të fondit të planifikuar vjetor.

**Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqerore** (zeri 600-601), është realizuar në zbatim te strukturës organizative të miratuar, me VKM Nr. 769, date 15.07.2009 dhe te VKM Nr. 55 Date 26.01.2011 “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2011, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”.

Gjatë 3- mujorit të fundit të vitit 2013, numri mesatar i punonjësve është realizuar 13 punonjes.

Nga fondi i pergjithshem i pagave dhe shperblimeve, si dhe i sigurimeve shoqerore, per këtë periudhë, është realizuar respektivisht;

**10,158,009 Lekë** (zeri 600) për paga, realizimi **92.3 %**

**1,627,595 Lekë** (zeri 601) për kontribute për sigurimet shoqërore, realizimi **95.7 %**

**Fondi per shpenzime në zerin Mallra dhe Shërbime** (zeri 602), per vitin 2013, është planifikuar ne vlerën **7,000,000 leke**.

Duke qene se nevoja per te disbursuar fonde per projektet ka qene e larte, eshte kerkuar nga AMSHC dhe eshte aprovuar nga Ministria e Financave nje Transferim fondi prej **3,000,000 lekesh** nga Llogaria 602 (pakesim ) ne llogarine 604 (shtim fondi) aprovuar kjo e fundit nepermejt shkrese zyrtare te Ministrise se Financave/Drejtoria e pergjithshme e Buxhetit me Nr.Prot.7651/1 te dt.22.05.2013.

Gjithashtu, ne kuader te Detajimit te Aktit normativ te Buxhetit te Vitit 2013, llogaria 602 u pakesua me **1,000,000 leke**.

Ne kuader te organizimit te nje aktiviteti social – kulturor per AMSHC ne, u akorduar nga Ministria e Financave nje fond prej **10,000 lekesh** nga llogaria e Fondit te Kontigjences per Fondin e vecante.

Pas ndryshimeve ne llogarine 602 te permdendura me lart dhe te dokumentuara ne menyre te sakte shkresore, llogaria 602 ne buxhet eshte realisht **3,010,000 leke**.

Edhe për këtë zë, për periudhen respektive është realizuar vlera prej **2,386,130 Lekë** ose **79.2 %** e planit vjetor per llogarine e Mallra dhe Shërbime 602.

Në realizimin e shpenzimeve operative, AMSHC është mbështetur në nje shpërndarje sa më racionale të kërkesave, të cilat lidhen me;

- Realizimin e shpenzimeve, te detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, uje, shërbime postare e telefonike falas per publikun, ne funksion te nje veprimtarie normale institucionale.

- Kyerjen e te gjitha blerjeve per nevoja te AMSHC, publikime, blerje kancelarike, riparime automjeti, etj.

- Kryerjen e pagesave per likuidimin e detyrimeve furnitore dhe te trete, te mbartura nga 2012.

**Fondi në zerin per Transferime Korrente te Brendshme** (zeri 604), per vitin 2013 është planifikuar ne vlerën **96,700,000 leke**.

Me ndryshimet ne Buxhet te reflektuara dhe me lart ky ze u **be 99,700,000 leke (Shkresa nga Ministria e Financave me Nr.prot 7651/1, dt.22.05.2013)**.

Ky eshte dhe zeri me me peshe ne strukturen e buxhetit te AMSHC, duke qene se dhe vete misioni i ketij institucioni ka si qellim kryesor financimin e Shoqerise Civile me Grante per projektpropozimet te OJF perfituese.

Edhe për këtë zë, për periudhen respektive është realizuar vlera prej **99,691,500 Lekë** ose **99.99 %** e planit vjetor.

Në realizimin e ketij zeri, AMSHC ka vazhduar me disbursimet per këstin e dyte (40%) e thirrjes së tretë, me pjesen e trete(10%) si dhe disbursimet perkatese sipas kontratave te nenshkruara per Thirrjen Nr.4 te shpallur dhe te kontraktuar ne vitin 2013 .

**Fondi per shpenzim investime** (zeri 231) ,

**1,500,000 Lekë** (zeri 231) për Investime te Trupezuar nga te cilat per periudhen respektive pra deri ne Dhjetor 2013 jane shpenzuar **185,664 leke** sipas rakordimeve me Thesarin te muajin Dhjetor me realizimin **12.3 %**.

AMSHC, ka zbatuar me korrektesi te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga Ligji Nr. 10093 Date 09.03.2009 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Agjencise per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile", si dhe legjislacionin admnistrativo-financiar shqiptar.

**Drejtore Ekzekutive**

**RUDI BOBRATI**